



Më  
Dana

09.10.2018



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**

Numri i lëndës: 2018:009014

Datë: 07.03.2018

Numri i dokumentit: 00018650

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL** Sipas gjuqtarit Adem Shabani, me pjesëmarrjen e procesmbajtësit Blend Rexhepi në lëndën penale kundër të pandehurit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna Ferizaj, me numër personal [REDACTED] për shkak te veprës penale usurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga Neni 332 par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.04/L-082 (KPRK), duke vendosur sipas aktakuzës së Prokuroria Themelore Ferizaj - Departamenti i përgjithshëm nr. PP.nr.308-5/14, të datës 20.10.2017 në seancën publike të shqyrtimit filletar të mbajtur me datë 07.03.2018, në praninë e Prokurorit të Shtetit Bahri Hyseni, të pandehurit [REDACTED] të dëmtuarit [REDACTED] më datë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 07.03.2018 përpiloji, këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna Ferizaj, i lindur më [REDACTED], në të njëtin vend, nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, babë i katër fëmijëve, ka të kryer shkollën filllore, është në pension, i gjendjes së mesme ekonomike, mbrohet në liri, i padënuar deri me tanë, me nr.personal [REDACTED]

**ËSHTË FAJTOR**

Sepse me datë 14.01.2014 në fshatin Sojevë Komuna Ferizaj në mënyrë të kundërligjshme ka usurpuar pronën e paluajtshme – tokën bujqësore-livadh, të identifikuar me certifikatën kadastrale me numër 10926-2017 në sipërfaqe prej 65.95 m<sup>2</sup>, në vendin e quajtur “kodra”, zona kadastrale fshati Sojevë, pronë e të dëmtuarit [REDACTED] në atë mënyrë që

këtë sipërfaqe të tokës e ka mbjellë me bimë të ndryshme bujqësore, me ç'rast i ka pamundësuar të dëmtuarit të shfrytëzoj pronën e tij,-

-me këtë ka kryer veprën penale uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par. 1 të KPRK-së,

Andaj gjykata në bazë të dispozitës së lartë përmendur dhe nen. 4, 7, 17, 23, 41, 42, 43, 51, 52, dhe 73 të KPK-së dhe nen. 365 të KPPK-së të pandehurit i shqipton:

### GJYKON DËNIM ME KUSHT

Të akuzuarin [REDAKTUE] e gjykon dënim burgimi në kohëzgjatje prej 4 /katër/ muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjeter penale

Obligohet i akuzuari që në afate prej 30 ditëve në mënyrë vullnetare ta liron uzurpimin e paligjshëm të pronës-tokën bujqësore-livadh, në sip. prej 65.95 m<sup>2</sup>, në vendin e quajtur "Kodra", ZK fshati Sojevë, pronë e të dëmtuarit [REDAKTUE], e identifikuar me certifikatën kadastrale me numër 10926-201 e lëshuar nga Zyra Kadastrale në Ferizaj me dt. 06.02.2017, e nëse nuk e liron uzurpimin e pronës në mënyrë vullnetar në afatin e cekur më lartë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi do të ekzekutohet në mënyrë të dhunshme.

Obligohet i akuzuari të paguaj shpenzimet e procedures penale-paushallin gjyqësor në shumë prej nga 20 (njëzetë) €uro, dhe i shqiptohet taksa në shumën prej 30 €uro, konform nenit 39 paragrafi 3 nën paragraghi 3.1 të Ligjit për Kompenzimin e Viktimave të krimít ti paguaj të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

### Arsyjetim

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP.nr.308-5/14, të datës 20.10.2017, ka ngarkuar të akuzuarin [REDAKTUE] nga fshati Sojevë Komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga Neni 332 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar rreth kësaj çështje penale konform nenit 245 par.1 të KPPRK-së me dt. 07.03.2018, ka mbajtur shqyrtimin fillestar në të cilin kanë marrë pjesë prokurori i shtetit, Bahri Hyseni, i akuzuarin [REDAKTUE] dhe i dëmtuarin [REDAKTUE]

Në fillim të shqyrtimit fillestar i akuzuarit është udhëzuar në kuptim të nenit 246.1 të KPPRK-së pastaj gjyqtari gjykues ka çmuar se të drejtat e të akuzuarit janë respektuar, e më pas prokurori i shtetit ka lexuar aktakuzën të akuzuarit dhe pasi që gjyqtari është bindur se i njëjtë e ka kuptuar në tërësi aktakuzën me të cilën është akuzuar, të njëjtë i ka dhënë mundësi të deklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë e tij lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet.

I akuzuari [REDACTED], ka pranuar fajësinë për veprën penale që akuzohet si në dispozitiv të aktakuzës dhe në vazhdim ka deklaruar se unë që nga dita e sotme do ta liroj nëse ka usurpim prone dhe të dëmtuarin nuk do ta pengoj në posedimin e lirë dhe të qetë, i kërkon falje të dëmtuarit për veprën që akuzohet dhe i ka prentuar Gjykatës që nuk do të përsërisë ndaj të dëmtuarit dhe ndaj askujt veprime inkriminuese dhe është hera e parë që ndeshm me ligjin.

Gjyqtari në kuptim nenit 248 par.1 nën.par.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe par.4 të KPPK-së, është e bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht duke e mbështetur në provat që përmban aktakuza dhe në materialet e prezantuara nga ana e prokurorit të shtetit.

Pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit gjyqtari në kuptim të nenit 248 par.2 të KPPK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë, mbrojtësit dhe të dëmtuarit.

Prokurri i shtetit Bahri Hyseni ka theksuar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit pasi i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarishtë dhe e ka mbështetur në faktet e çështjes që përbën akusa, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe pasi akusa nuk përbën asnjë shkelje ligjore pra pranimi i fajsisë është bërë konform ligjit.

I dëmtuari [REDACTED] pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të dëmtuarit dhe i propozojmë Gjykatës që në këtë fazë ta bëjë pranimin e fajësisë, pasi që i akuzuari ka deklaruar se unë do ta liroj pronën për të cilën akuzohem që unë nga dita e stome në patundshmërinë time të jem i lirë dhe i qetë si çdo pronar në pasurinë e tyre. Po ashtu me të pandehurin jemi fqinjë dhe në të kaluarën nuk kemi pasur kurrfarë problemi sa i përket usurpimeve të paluajtshmërisë.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vetëtar se i akuzuari pranimin e fajësisë e ka mbështet në provat që gjenden në shkresat e kësaj lënde penale dhe ate: në certifikatën kadastrale me nr. 10926-17 të datës 06.02.2017 lëshuar nga Zyra Kadastrale në Ferizaj, në emër të të dëmtuarit, ku është evidentuar parcela P-72217082-00701-0, zona kadastrale Sojevë.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjiths elementet e veprës penale usurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga Neni 332 par. 1 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së dënimit gjykata i ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 dhe 74 i KPRK-së të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin gjykata ka marrë për bazë pranimin e fajit nga i akuzuari, pendimin e tij, sjelljen korrekte të tij gjatë tërë procedurës, kërkim falje të dëmtuarit; premtimin se më nuk do ta pengoj në shfrytëzimin e pronës. Gjykata është e bindur se dënim i shqiptuar si në dispozitiv të aktgjykimit është në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe peshën e veprës penale, kështu që dënim i shqiptuar

denim me burg në kohëzgjatje prej 4 /katër/ muaj me kusht i cili dënim nuk do të ekzekutohet, po që se në afat prej 1 viti (koha e verifikimit) pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, do arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPK-së, ai rehabilitues që i njëjti në të ardhmen të përmbahet nga kryerja porse të parandaloj edhe të tjerët që të kryejnë vepër penale si dhe reagimin shoqëror ndaj një veprimi të tillë.

Gjykata konform nenit 463 parag.1 lidhur me par 3.të KPPK-së të dëmtuarin [REDAKTUE] nga Ferizaj rr.[REDAKTUE] për realizimin e kërkesës pasurore-juridike e ka udhëzuar në kontest civil.

Vendimi mbi kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është sjell në bazë të nenit 450 par.2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPK-së dhe nenit 39 parag.1 nën par. 3.1 të Ligjit për Kompenzimin e Viktimave të Krimit Nr.05/L-036.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal,  
**P.nr.2644/17, me datë 07.03.2018**

Zyrtari Ligjor  
Blend Rexhepi

Gjyqtari  
Adem Shaban



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.